



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2020:024221

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06377736

C.nr.285/20

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve "Illyria", sh.a., me seli ne Prishtine, te cilen sipas autorizimit e perfaqeson A.L. kundër të paditurit E.S. nga fshati Grenqar, Komuna e Prizrenit, te cilin sipas autorizimit e perfaqeson Av. N.M. nga Prizreni, per ceshtjen juridike me objekt kontesti rimbursim dëmi, lartësia e objektit të kontestit 687.00 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 04.10.2024, mori, ndersa me datë 28.10.2024 hartoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve "Illyria", Sh.a. me seli në Prishtinë, **DETYROHET** i padituri E.S. nga fshati Grenqare, Komuna e Prizrenit, që paditëses t'ia kompensojë shumat dhe ate: ne emer te rimbursimit te demit, shumen e paguar per NTP ..... ne vler prej 472 euro, si dhe ne emer te rimbursimit te demit, shumen e paguar per I.M. ne vlere prej 215 euro, e ne shume te pergjithshme prej 687.00 €, per aksidentin e trafikut te shkaktuar me datë 14.06.2019, me kamatë ligjore prej 8% në vit, respektivisht per shumen prej 472 euro nga data 12.09.2019, ndersa per shumen 215 euro nga data 06.01.2020, deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshem.

**II. DETYROHET** i padituri që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës konkestimore në shumë prej 20.00 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshem.

### **Arsyetim**

Paditësja Kompania e Sigurimeve "Illyria", SH.A me seli në Prishtine, me datë 19.02.2020, prane kesaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit E.S. nga fshati Grenqar, Komuna e Prizrenit, me objekte te kontestit rimbursim i demit. Ne padi paditesja ka theksuar se i padituri me date 14.06.2019, ka shkaktuar aksident trafiku ne rrugen Prizren-Recan, nen ndikimin e alkoohlit, duke drejtuar automjetin e markes VW, tipit Passat, me nr. te targave ..... i cili automjet ne kohen e aksidentit ka qene i siguruar me police te sigurimit tek ketu paditesja. Tutje paditesja ka pohuar se lidhur me aksidentin e shkaktuar nga i siguruari E.S. ka bere zhdemtimin e demit material te parashtruar nga ana e te demtuarit NTP ..... ne vlere prej 472.00 euro.

Me parashtresen e dates 02.06.2021, paditesja ka bere pecizimin e padise sa i perket lartesis se kerkeses, ashtu qe ne emer te rimbursimit te demit, per shumen e paguar per NTP ..... prej 472 euro, si dhe ne emer te rimbursimit te demit, shumen e paguar per I.M. prej 215 euro, e ne shume te pergjithshme prej 687.00 €, per aksidentin e trafikut te shkaktuar me datë 14.06.2019, me kamatë ligjore prej 8% në vit, respektivisht per shumen prej 472 euro nga data 12.09.2019, ndersa per shumen 215 euro nga data 06.01.2020, deri në pagesën përfundimtare.

I padituri nuk ka paraqitur pergjigje ne padi, edhe per kunder faktit se i njeiti me date 09.03.2020, ka pranuar aktvendimin per pergjigje ne padi se bashku me shkresat e lendes.

Edhe pergjate seancave gjyqesore dhe ne fjalen perfundimtare i autorzuar i paditeses A.L. ka deklaruar se mbese prane padis dhe kerkespadise, ku nga provat

e admisnitruara është vertetuar baza juridike e padise dhe fakti se i padituri e ka shkaktuar aksidentin duke qene nen ndikimin e alkooholit, cka edhe ka ndikuar ne humbjen e mbuleses siguruese tek paditesja. Ku sipas Ligjit per Sigurimin e Detyrueshem nga Autopergjegjesia, paditeses i'u eshte krijuar e drejta qe te beje regresin per demet te cilat ia ka shkaktuar paditeses. Gjykates i ka propozuar qe te aprovoj padine dhe kerkese padine sipas precizimit te bere me date 02.06.2021. Shpenzimet e procdures i ka kerkuar dhe ate ne emer te pageses se takses gjyqesore shumen prej 20 euro.

I autorizuari i te paditurit Av. N.M. ne seancat gjyqesore dhe ne fjalen perfundimtare ka deklaruar se e kundershton padine dhe kerkesepadinë e palës paditese, pasi qe e njejta eshte e pambeshtetur ne prova dhe fakte. Tutje ku deklaruar se edhe nga administrimi i provave nuk eshte vertetuar gjendja reale ku potencohet se i padituri e ka shkaktuar aksidentin nen ndikimin e alkooholit, mungon skica e terrenit, si dhe provat jane siguruar nga paditesja ne menyre joligjore, vecanarisht fotodokumentacioni. Ndersa sa i perket lartsise se kerkeses, i njejti e ka kundershtuar proven - faturen nga Auto Servis Baci, per shkak se nuk theksohet saktesisht se cka eshte riparuar nga automejti. I njejti ka deklaruar se per kete ceshtje Gjykata Themelore ne Prizren, me aktvendimin Nr.163/20, eshte pezulluar procedura kundervajtjes ndaj te paditurit. Gjykates i ka propozuar qe ta refuzoj kerkesepadine si te pabazuar. Shpenzimet e procedures i ka kerkuar sipas tarifes se OAK-se.

*Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar.*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: Raportin e Policise se Kosoves me nr. 2019-GR-032, te dates 14.06.2019, Procesverbalin mbi demtimin e automjetin, i perpiluar nga paditesja per te demtuarin NPT ..... i dates 24.06.2019, Shiqimi ne fotografite nga faqja 8, deri ne faqe 11 te shkresave te lendes, Certifikata e Regjistrimit te automjetit ne emer te NTP ..... Fatura me nr. 154/19, e dates 06.08.2019, e leshuar nga Auto Servis Baci, Deklarata e pranimit per riparimin e mjeteit e dates 04.07.2019, Raporti - transferi bankar i dates 18.09.2019, Fleteparaqitja e demit nga autopergjegjesia e dates 26.06.2019, Libreza e

Sigurimit ne emer te I.M. Procesverbali mbi demtimin e automjetit te dates 27.06.2019, Shiqimi ne kater fotografit te automjetit te llojit Passat, Raporti mbi vleresimin e dates 10.07.2019, te bere nga paditesja, Pajtimin jashte gjyqesor i lidhur ne mes te paditeses dhe I.M. i dates 27.12.2019, Raporti i transferit bankar i dates 06.01.2020, si dhe Aktvendimi me nr. 163/20, i dates 09.11.2021, i nxjerr nga Gjykata Themelore Prizren- Divizioni i Kundervajtjes.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ( LPK ), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

*Kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.*

Nga Raporti i Policise se Kosoves, me nr. 2019-GR-032, te dates 14.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti ka ardhur deri sa vozitesi i automjetit "A", ketu paditesi ka qene duke vozitur nen ndikimin e alkooholit me 1.62% promila, nga Prizren ne drejtim te fshatit Recan, i njeiti hyne ne tejkalim te pasigurt te automjetit "C" ,VW Golf, ku del balle per balle me automjetin "B", i cili ka qene ne qarkullim ne drejtimin te kundert- ne shiritin e vet levizës, mirëpo këtë veprim nuk e merr si duhet, ne pamundesi te tejkalimit te automjetit "C", ne pjesen anësore te majtë rreshqet e godet automjetin "B" , ne anen e majte, e me pas ne anën e djathtë e godet automejtin "C", me ç'rast shkaktohet aksident me dëme materiale ,ku lëndime te lehta merr vozitesi i automjetit "A".

Me leximin e procesverbalit mbi demtimin e automjetit per te demtuarin N.P.T "....", i dates 24.06.2019, gjykata vertetoi faktin se ketu i demtuari në momentin e ndodhjes se aksidentit te dates 14.06.2019, ishte duke drejtuar autmjjetin e tipit Peugeot 308, i vitit 2008, me nr. te regjistrimit 04-218-EK, ku te njejtit i'u jane demtuar keto pjese: mbrojtasi-shina e mbrojtases, fari (mbrojtaset e farit majtas), mbrojtasi i baltes nga krahu i majte, dera-pjesa e llamarines (m+d), pasqyra e jashtme majtas, pragu djathtas, faqaja anesore majtas, si dhe dera-pjesa e llamarines (m+d).

Me shiqimin ne fotografite te cilat ne shkresat e lendes gjenden nga faqja tetë, e deri ne faqe njëmbëdhjetë, gjykata vertetoi faktin se vetura “B”, e cila pesoi demtime ne aksidentin e dates 14.06.2019, te shkaktuar nga i padituri E.S. ka qene veture e tipit Peugeot 308, i vitit 2008, me nr. te regjistrimit 04-218-EK.

Nga leximi i Certifikates se Regjistrimit per automjetin e regjistruar ne emer te N.T.P “.....”, gjykata vertetoi faktin se vetura i perket tipit Peugeot 308, e vitit te prodhimit 2008, me ngjyre e hirit metalike, me pese dyer, me nr. te regjistrimiti 04-218- EK.

Nga leximi i fatures me nr.154/19, e dates 06.08.2019, e leshuar nga Auto Servis Baci, gjykata vertetoi faktin se paditesja ka kryer pagesen ne shume prej 472.00 euro, ne emer te riparimit per automjetin e tipit Peugeot 308, me targat e regjistrimit 04-218-EK.

Me leximin e deklarates se pranimit per riparim te mejtit e dates 04.07.2019, gjykata vertetoi faktin se E.A. si pjesemarres ne aksidentin e dates 14.06.2019, me automjetin e tipit Peugeot 308, me targa te regjistrimit 04-218-EK, ka deklaruar se ketu paditesja KS “Illyria” ka permbushur te gjitha detyrimet financiare per riparimin e automjetit te demtuar, riparim i bere nga Auto Servis “Baci”, ku me date 04.07.2019, i’u eshte bere dorezimi i automjetit te riparuar pronarit E.A.

Nga leximi i raportit- transferit bankar te dates 18.09.2019, gjykata vertetoi faktin se paditesja KS “ Illyria”, ka kryer pagesen per Auto Servis Baci, ne emer te riparimit te automjetit te demtuar, shumen prej 472.00 euro.

Me leximin e fletëparaqitjes se demit nga autopërgjegjësia, e dates 26.06.2019, gjykata vertetoi faktin se dem material ne aksidentin e dates 14.06.2019, te shkaktuar nga ketu u padituri E.S. ka pesuar edhe automjeti i tipit VW Golf, me targa te regjistrimit W96638G, me pronar I.M.

Nga leximi i librezes së sigurimit në emër të I.M. gjykata vërtetoi faktin se automjeti pjesëmarrës në aksidentin e datës 14.06.2019, i përket tipi Volkswagen Golf, e regjistruar në emër të I.M.

Nga leximi i procesverbalit mbi dëmtimin e automjetit të datës 27.06.2019, gjykata vërtetoi faktin se këtu i dëmtuarin në momentin e ndodhjes së aksidentit të datës 14.06.2019, ishte duke drejtuar automjetin e tipit VW Golf, i vitit të prodhimit 2007, me nr. të regjistrimit W96638G, e me nr. identifikues-shasise të automjetit WWWZZZIKZBW128647, pjesët e dëmtuara të veturës sipas aksidentit të shkaktuar nga këtu i padituri E.S. janë: Mbrojtësi-shina e mbrojtësit, mbrojtësi i baltes, si dhe bandashi.

Me shiqimin në fotografite për automjetin e tipit Passat (GOLF), gjykata vërtetoi faktin se vetura "C" e cila pësoi dëmtime në aksidentin e datës 14.06.2019, të shkaktuar nga i padituri E.S. i përket tipit VW Golf, me nr. të regjistrimit W96638G.

Nga leximi i raportit të vlerësimit të datës 10.07.2019, raporti i bërë nga këtu paditësi KS "Illyria", gjykata vërtetoi faktin se vlera e dëmtimit të pesuar në aksidentin e datës 14.06.2019, për veturën e tipit VW Golf, vitit 2007, është shuma në vlerë prej 214.60 euro.

Nga pajtimi jashtëgjyqësor i datës 21.12.2019, në mes këtu paditëses KS "Illyria", dhe I.M. gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me të dëmtuarin I.M. në emër të kompesimit të plote, për dëmtimin material si pasojë e aksidentit 14.06.2019, të shkaktuar nga i sigurari në KS "Illyria", kanë lidhur marrëveshje për zhdëmtim në shumë prej 215.00€.

Me leximin e raportit-transferit bankar të datës 06.01.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi KS "Illyria", ka kryer pagesën për Automobile Sh.p.k., në emër të riparimit të automjetit të dëmtuar, shumën prej 215.00 euro.

Nga leximi i Aktvendimit me Nr.163/20, i dates 09.11.2021, i nxjerr nga Gjykata Themelore ne Prizren- Divizoni i Kundervajtjes, gjykata vertetoi faktin se gjykata ka pezulluar proceduren kundervajtjese kunder te pandehurit E.S. i cili me date 14.06.2019, ka shkakuar aksidnet trafiku duke qene nen ndikimin e alkooholit, per shkak te arritjes se parashkrimit absolut per zhvillimin e procedures kundervajtjes.

*Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtarë i gjykatës,*

Baza juridike e kërkesëpadisë, që i padituri të jetë përgjegjës për rimbursimin e dëmit paditëses, gjejnë mbështetje në dispozitën e nenit 14 par. 1 pika 1.3 të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ku thuhet se “ I sigurari e humbë mbulesen siguruese, kur mjeti motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive”, Ndërsa neni 245, paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve parasheh se “kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”.

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndergjyqese, si dhe provave të administruara, duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartekura dhe gjendjes faktike të vërtetuar, vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe se të njëjtën e aprovoj në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar se me datën 14.06.2019, rreth orës 20:30, në rrugën Prizren- Recan, i padituri E.S. ka qenë duke drejtuar automjetin e markës VW “ Passat”, me targa ..... nën ndikimin e alkoolit 1.62% promila, ku ka hyre në tejkalim të pasigurt të vetures VW Golf, por që këtë veprim nuk e kishte ndërmarrë konform rregullave të komunikacionit rrugor dhe gjate tejkalimit godet veturen e tipit Peugeot, dhe kështu e ka humbur kontrollin mbi automjet dhe ka goditur veturen VW Golf, me c’rast i’u shkakton dëme materiale të specifikuara si më lartë, si dhe lëndime të lehta trupore pëson vet ketu i padituri, e gjithë kjo vertetohet nga Raporti i Policise se Kosves mre nr. 2019-GR-032. Përmes procesverbaleve për vlerësimin e dëmit të veturës dhe faturave të paguara, gjykata

vërtetoi faktin dëmin material në veturat të cilat kanë pësuar nga aksidenti i trafikut. Ndërsa lidhur me kërkesat për kompensimin e dëmit material, Kompania e Sigurimeve "Illyria" me seli Prishtinë, ku në kohën e aksidentit ka qene i siguruar ketu i padituri E.S. ka arritur ujdj jashtëgjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të dëmit dhe shpenzimeve në shumën prej 215.00€, me të dëmtuarin I.M. Pretendimet e paditeses sa i perket lartesis se kërkesepadise, janë vërtetuar nga provat e administruara e sidomos Transaksioneve bankare te dates 18.09.2019, si dhe transkasioni bankar i dates 06.01.2020, të cilat prova nuk janë kundërshtuar ne permbajtje nga pala e paditur gjate procedures se administrimit te te njejtave, andaj gjykata provave të lartcekura ua fali besimin dhe e aprovoi kërkesëpadie e paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e gjen se paditësja, bazuar në dispozitën e nenit 14 par. 1 pika 1.3 të LSDA, ka të drejtë të kërkojë rimbursim nga shkaktari i dëmit, i cili në kohën e shkaktimit të aksidentit ka qene nen ndikimin e alkoolit, dhe sipas gjendjes faktike të vërtetuar nga kjo gjykatë, shkaktar i aksidentit të datë 14.06.2019, ishte këtu i padituri E.S. i cili drejtonte automjetin e tipit VW Passat me targa të regjistrimit ..... Ndërsa në anën tjetër paditësja, bazuar në dispozitat ligjore kishte kompensuar të dëmtuarit në kete aksident N.T.P. "Galaxy Granit", si dhe I.M. në shumë të përgjithshme prej 687.00 €.

Sipas dispozitës së nenit 7, paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-006 Për Procedurën Kontestimore ( tutje LPK), *"Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla"*, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319, paragrafi 1 të LPK, thuhet se *"Secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta"*.

I padituri si prove te vetme ka paraqitur Aktvendimin Nr.163/20, te dates 09.11.2021, te nxjerr nga Gjykata Themelore Prizren- Divizioni i Kundervajtjes, me te cilin aktvendim eshte pezulluar procedura kundervajtëse ndaj te paditurit E.S. për shkak te arritjes se parashkrimit absolut. Gjykata pas vlersimit te kesaj prove erdh ne perfundim se edhe per kunder faktit se procedura kundervajtjse eshte pezulluar dhe nuk eshte zgjidhur cershtja ne menyre meritore, ky fakt nuk e verteton te kunderten se ketu i padituri nuk eshte pergjegjes per shkaktimin e aksidentit nen



ndikimin e alkoolit me 14.06.2019, nga aksident i cili kan pesuar demtime materiale dy automjete.

Gjykata, duke u bazuar në gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil i të paditurit, ndaj paditëses për rimbursimin e dëmit, në shumën prej 687.00 €, e duke u mbështetur në nenin 245 paragrafi 1, të LMD-se, e lidhur me nenin 14 par. 1 pika 1.3 të LSDA, pasi që paditësja ka paguar në tërësi dëmin që e ka shkaktuar i padituri. Dhe si përfundim gjykata vlerëson se i padituri është përgjegjës për rimbursimin e dëmit ndaj paditëses, pasi që i njëjti e ka humbur mbulimin e sigurimit, për shkak se e ka përdorur automjetin në ndikimin e alkoolit, andaj gjykata ka obliguar të paditurin që paditëses t'ia rimbursojë dëmin në shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga datat e përcaktuara sikurse në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 449 dhe 452 të LPK-se, sipas të ciles paditëses i aprovohen shpenzimet e kerkuara në shumë prej 20.00 € në emër të taksës gjyqesore.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.285/20, me datë 28.10.2024**

Numri i lëndës: 2020:024221  
Datë: 31.10.2024  
Numri i dokumentit: 06377736

**Gjyqtari**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLËJURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të njëtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.